



Pranuar / Dorezuar Punëdhënësi/Prodatori Received/Delivered	06.06.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednitsa Org/Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shifra Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	3296/2022		117



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 854/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësi të procesmbajtësit, duke vendosur në riprocedurë sipas ankesës A.nr.854/2021 të datës 07.10.2021 të ankuesit me adresë banimi

kundër organit të punësimit Këshilli Prokurorial i Kosovës, në çështjen juridike-administrative "ndërprerje e marrëdhënies së punës", e në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 06.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa e riaktivizuar A.nr.854/2021 e datës 07.10.2021 e parashtruar nga ankues.

II. Anulohet Vendimi KPK/Nr.661/2021 i datës 24.08.2021 dhe numër protokoli 1301/2021 të datës 14.09.2021 të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale e ankuesit masën disiplinore "ndërprerje e marrëdhënies së punës" e shqiptuar sipas vendimit nga pika II e dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke vendosur lidhur me ankesën e ankuesit A.nr. 854/2022 të datës 07.10.2021, me Vendimin A.nr. 854/2021 të datës 01.12.2021, ka shfuqizuar Vendimin KPK/Nr.661/2021 të datës 24.08.2021 dhe me numër protokoli 1301/2021 të

datës 14.09.2021 të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe ka kthyer çështjen në rivendosje dhe rishqyrtimin tek organi i njëjtë.

Këshilli Prokurorial i Kosovës me datë 24.12.2021 ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me kërkesën për anulimin e vendimit të Këshillit A.nr.845/2021 të datës 01.12.2021 dhe propozimin për shtyrje të ekzekutimit të të njëjtit, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me Aktvendimin A.nr.3089/2021 të datës 31.12.2022 ka refuzuar propozimin e palës paditëse për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të Këshillit. Pas Aktgjykimi të Gjykatës së Apelit AA.47/22 të datës 31.01.2022, Gjykata Themelore me Aktvendimin A.nr.3089/2021 të datës 11.02.2022 ka hedhë poshtë si të palejueshme padinë dhe propozimin e palës paditëse respektivisht Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Për shkak të mos zbatimit të vendimit të Këshillit A.nr.854/2021 të datës 01.12.2021 gjegjësisht mos rishqyrtimit të çështjes nga Këshilli Prokuroria i Kosovës (tutje KPK), me kërkesë të ankuesit procedura është rihapur në pajtim me nenin 19 paragrafi 3 të Rregullores 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se: *Në bazë të njoftimit për interes të vazhdimit të procedimit administrativ, sipas paragrafit 2 të këtij neni, Këshilli e riaktivizon lëndën e ankesës dhe nxjerr vendim përfundimtar në pajtim me afatin e përcaktuar ligjor.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 30.09.2021 dhe A.nr.07.10.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 13.09.2021 së bashku me kërkesën e bashkangjitur dërguar nga ankuesi për Kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës; E-mailin e datës 23.09.2021 me kërkesën e përsëritur dërguar nga ankuesi për Kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës; E-mailin e datës 13.09.2021 dërguar nga ankuesi për Drejtorin e Thesarit të Kosovës; E-mailin e datës 14.09.2021 me përgjigjen e bashkangjitur dërguar nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës për ankuesin; Njoftimin e Këshilli Prokurorial të Kosovës për ndërprerjen e marrëdhënien e punës së ankuesit të datës 24.08.2021; Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda më shifër PP.I.nr13/K21 dhe numër të lëndës:2021:0015416 të datës 10.02.2021 për fillimin e hetimeve ndaj ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 06.10.2021; Përgjigjen në kërkesë e datës 12.10.2021 me provat e bashkangjitura të lëndës; Vendimin e Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës të datës 24.08.2021 i protokolluar me datë 14.09.2021 dhe numër KPK/Nr.661/2021; Vendimin e datës 14.01.20219 të Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës me numër KPK/Nr.20/2019; Kontratën e marrëdhënies së punës së ankuesit e datës 13.02.2019 së bashku me përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësiive të punës; Raportin e Komisionit Hetimor të datës 23.04.2021; Vendimin e datës 28.05.2021 për themelimin e komisionit disiplinor nga Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës; vendimin e datës 29.06.2021 më numër KPK/Nr.425/2021 të Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Raportin e Komisionit Disiplinor të datës 27.07.2021; E-mailin e datës 11.08.2021 dërguar nga _____ për _____ me korrespondencën e bashkangjitur të prokurorit _____ Vendimin e datës 18.02.2021 më Nr.Prot.DPSKPK/63/2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Vendimin e datës 18.02.2021 me Nr.Prot.DPSKPK/64/2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Vendimin e datës 24.02.2021 me Nr.Prot.DPSKPK/71/2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Vendimin e datës 24.02.2021 me Nr.Prot.DPSKPK/72/2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Kërkesën për Planin e Personelit Administrativ për

vitin 2021 i datës 05.02.2021; Vendimin e datës 08.02.2021 me KPK/38/2021 të Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Formën tabelare të planit të personelit administrativ për vitin 2021 prej 6 faqesh; Vendimin e datës 08.03.2021 me KPK/138/2021 të Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Shkresën për dërgimin e raportit të Komisionit ad-hoc të datës 05.07.2021; Ftesën për seancë të datës 02.07.2021; Raportin e zyrtarit E-mailin e datës 07.07.2021 dërguar nga për dhe Kopjen e zarfit të datës 15.07.2021; Kopjen e zarfit të datës 02.07.2021; E-mailin e datës 16.07.2021 dërguar nga Narcise zyrtarë e Postës së Kosovës për me korrespondencën prej 7 faqesh; E-mailin e datës 30.08.2021 dërguar nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës për me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 faqesh; Formulari i të dhënave për listën e pagave për ankuesin e datës 25.08.2021; E-mailin e datës 25.08.2021 dërguar nga për Kopjen e librit të pranimit të shkresave nga Posta e Kosovës e datës 14.09.2021; e-mailin e datës 25.11.2021, Vendimin KPK/Nr.57/2021 të datës 02.03.2021, Aktakuzën PP/I.nr.13K/2021 të datës 03.08.2021; e-maili i datës 14.03.2022, i ankuesit lidhur me aktivizimin e lendes; e-maili i datës 12.01.2022; Aktvendimi A. Nr. 3089/20212, i datës 11.02.2022, i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Aktvendimi A.Nr. 3089/20212 i datës 31.12.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Përgjigjen në ankesë të datës 20.10.2021; Vendimin e Këshillit A.nr.854/2021 të datës 01.12.2022; Aktvendimin A.nr.3089/2021 e datës 31.12.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktvendimin A.nr.3089/2021 i datës 11.02.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Aktvendimin numër AA.nr.47/22 i datës 31.01.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative; E-mailin e datës 31.12.2021 dërguar nga V. K për Këshillin i protokolluar me numër 86/2022 me korrespondencën e bashkangjitur prej dy (2) faqesh; E-mailin e datës 21.04.2022 dërguar nga ankuesi me nr.prot: 2290/2022 të datës 21.04.2022 fq ¼, emailin e datës 03.06.2022 dërguar nga Menaxherja e Personelit të SKPK me numër protokollit 3257/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar së është pjesërisht e bazuar ankesa e ankuesi

SEPSE:

Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht Vendimit KPK/Nr.20/2019 të datës 14.01.2019 dhe numër protokollit 58/2019 të datës 21.01.2019, ankuesit i ishte vazhduar për tri vite mandati i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës respektivisht për periudhën nga data 13.02.2019 deri me datë 12.02.2022.

Këshilli Prokurorial i Kosovës përmes Vendimit me numër 132/2021 të datës 25.02.2021, i ndryshuar dhe plotësuar me datë 26.03.2021, ka themeluar Komisionin *ad hoc* hetimor në përbërje prej tre anëtarëve, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës në këtë rast ankuesi, lidhur me zbatimin e Planit të Personelit për vitin 2021, si dhe vendimeve tjera që Komisioni Hetimor i konsideron si relevante për hetim.

Përmes Vendimit KPK/Nr.57/2021 të datës 02.03.2021 të Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ankuesi është pezulluar nga ushtrimi i detyrave zyrtare me pagesë 50% të pagës, për shkak se i njëjti me datë 01.03.2021 me urdhër të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë ishte arrestuar dhe së Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda me Aktvendim PP.I.Nr.13k/21 të datës 10.02.2021 ka filluar hetimet me dyshimin se në pozitën e Drejtorit të

Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së ka kryer vepër penale nga neni 422 dhe 414 të Kodit Penal të Kosovës.

Komisioni Hetimor pas vendimit për pezullimin parandalues të ankuesit, ka zbatuar hetimet lidhur me ankuesin sipas autorizimeve të përcaktuara me Vendimin me numër 132/2021 të datës 25.02.2021, ku me datë 23.04.2021 i njëjti ka dorëzuar raport me shkrim në KPK, me konstatimet se ankuesi në cilësi të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së ka bërë shkelje si në vijim:

- *Ka vënë në lajthitje KPK-ën lidhur me Planin e Personelit të vitit 2021, pasi që i njëjti nuk është dashur të miratohet nga KPK-ja pa u trajtuar nga Komisioni Parlamentar për Buxhet, Financa dhe Personel, i cili sipas Komisionit Hetimor nuk ka qenë i formuar por është dashur të pritët deri në themelimin e tij e pastaj të prezantohet për miratim në KPK;*
- *Prezantimi i Planit të Personelit për vitin 2021 i KPK-së, është bërë në kundërshtim me praktikën e krijuar pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, ashtu që këtij plani është dashur që ti bashkëngjiten edhe kërkesat që kanë të bëjnë me pozitat e reja, bazën ligjore që mundëson këtë, përshkrimin e detyrave dhe koeficientet e pagës si dhe shpalljet e konkurseve për pozitat aktuale si pjesë e Strukturës organizative të KPK-së;*
- *Drejtori i Përgjithshëm me rastin e nxjerrjes së Vendimit DPSKPK/63/2021 të datës 18.02.2021 për caktimin e U.d të Kordinatorit të Zyrës dhe Vendimit DPSKPK/64/2021 të datës 18.02.2021 për caktimin e U.d të Zyrtares së Lartë Ekzekutive në Zyrën e Kryesuesit të KPK-së, ka vepruar në kundërshtim me nenin 3 paragrafi 2, nenin 26 dhe nenin 30 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, dhe se caktimi i tyre është bërë me automatizëm pa zhvillim të ndonjë procedure, si dhe pozita e Zyrtares së lartë ekzekutive në Zyrën e Kryesuesit të KPK-së nuk është e paraparë me Rregulloren e Sekretariatit të KPPK-së e as me Planin e Personelit të vitit 2021.*
- *Drejtori i Përgjithshëm i SKPPK-së edhe pse ka pas detyrim ligjor nuk ka bërë vlerësimin e performancës për vitin 2020 lidhur me zyrtarët që janë vartës të tij.*
- *Bazuar në Raportet e Auditorit të Brendshëm janë gjetur se Administrata e Sistemit Prokurorial nuk ka një akt lidhur me koeficientet e zyrtareve, ka mos përputhje-nivelizim të koeficiente për pozita të ndryshme si dhe nuk ka organogram të ri që do ishte në pajtim me Planin e Personelit të vitit 2021.*
- *Me rastin e kontratës "Furnizim me moblije ekskluzive për kabinetin e Kryesuesit të KPK-së", sipas Auditorit të Brendshëm janë bërë shkelje serioze ligjore dhe procedurale dhe së për këtë shkelje është ngritur hetim penal nga Prokuroria Themelore në Prishtinë.*
- *Kontrata "Furnizim dhe monitorim i dyerve dykrahëshe me Access Controll në objektin e KPK-së" sipas auditorit të brendshëm është po ashtu me shkelje ligjore sepse ka vërejtje për çmime të larta dhe se nuk janë marrë për bazë çmimet e tregut apo çmimoreve së përgatitur nga KRPP-ja.*

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 28.05.2021, ka nxjerrë Vendimin KPK/353/2021 për themelimin e Komisionit Disiplinor, përgjegjës për zhvillimin e procedurës disiplinore dhe propozimin e masës disiplinore ndaj ankuesit në pozitë të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së. Ky i fundit me Raportin e datës 27.07.2021, ka konstatuar se të gjeturat e Komisionit Hetimor sipas Raportit të datës 23.04.2021 janë evidente duke rekomanduar që ndaj ankuesit të shqiptohet masa disiplinore "ndërprerje e marrëdhënies së punës".

Me tej, Këshilli Prokurorial i Kosovës në mbledhjen e datës 24.08.2021 ka miratuar Raportin e Komisionit Disiplinor të datës 27.07.2021, dhe me Vendimin me numër KPK/Nr.661/2021 të datës 24.08.2021 i protokolluar me numër 1301/2021 të datës 14.09.2021, ankuesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të SKPPK-së. Kurse me datë 25.08.2021

Njësia e Burimeve Njerëzore ka përcjell tek zyrtaret përgjegjës të Thesarit të Kosovës formularin për largim të ankuesit nga lista e pagave duke filluar nga data 24.08.2021.

Ankuesi me datë 30.09.2021 parashtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil e regjistruar me numër A.nr.841/2021 kundër Njoftimit të shpallur në webfaqen e KPK-së të datës 24.08.2021 lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës, ndërsa pas pranimit të Vendimit me numër KPK/Nr.661/2021 të datës 24.08.2021 për ndërprerje të marrëdhënies së punës, ankuesi paraqet ankesë në KPMSHCK e regjistruar me numrin A.nr.854/2021. Meqenëse të dy ankesat bazohen në të njëjtën gjendje faktike dhe bazë ligjore, me Vendimin Nr.04/2021 të datës 10.11.2021 të Kryetarit të Këshillit, është bërë bashkimi i ankesave në ankesën me numër A.nr.854/2021.

Ankuesi në ankesën e tij parashtroi në Këshill pretendon se vendimi KPK/Nr.661/2021 i datës 24.08.2021 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, është nxjerrë me aplikim të gabuar të ligjit material, shkelje të dispozitave lidhur me procedurën administrative dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, duke kërkuar anulimin e vendimit të kundërshtuar, rikthimin në punë si dhe kompensimin e pagave dhe përfitimet tjera në mënyrë retroaktive nga data 24.08.2021.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji në riprocedurë konstatoi se arsyetimi i Vendimit me numër protokoli 1301/2021 i datës 14.09.2021 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të ankuesit është i mangët dhe i pamjaftueshmi pasi që i njëjti nuk përmban bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret, respektivisht organi i punësimit me rastin e përcaktimit të përgjegjësisë disiplinore ndaj ankuesit ka përcaktuar se ankuesi ka bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës, mirëpo në rastin konkret nuk është bërë kualifikimi i shkeljeve disiplinore në mënyrë specifike siç përcaktohet me dispozitat e nenit 66 paragrafi 2 Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht nenin 4, 5 dhe 6 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil të Kosovës, dhe si i tillë vendimi i kontestuar është në kundërshtim me nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Kolegji, po ashtu ka gjetur se Vendimi me numër protokoli 1301/2021 i datës 14.09.2021 i KPK-së, nuk përmban pjesën përmblylëse lidhur me ushtrimin e mjeteve juridike, si element i detyrueshëm i aktit administrativ, e mbi këtë bazë vendimi i ankimuar është në kundërshtim edhe me dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Me tej lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së Vendimit të atakuar me ankesë, Kolegji gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se Kryesuesi i Komisionit Hetimor, dhe anëtarët këtij komisioni, në rastin konkret kanë vepruar edhe si anëtarë të Komisionit Disiplinor, kështu që derisa anëtarët e lartcekur kanë vepruar si anëtarë të Komisionit Hetimor, me ç' rast kanë përgatitur raport me shkrim për KPK, mbi bazën e të cilit është iniciuar procedura disiplinore, dhe pjesëmarrja e tyre edhe në Komisionin Disiplinor me rastin e përcaktimit të përgjegjësisë disiplinore ndaj ankuesit, Kolegji vlerësoj se kjo bie ndesh me dispozitat e nenit 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.10 të Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i provave materiale lidhur me çështjen në riprocedurë ka konstatuar se Komisioni Disiplinor ka shpallur përgjegjës ankuesin edhe për çështje e Kontratës së tenderit "Furnizim me moblije ekskluzive për kabinetin e Kryesuesit të KPK-së", e për të cilën çështje sipas shkresave të lëndë është duke u zhvilluar procedurë penale sipas Aktakuzës PP/I.Nr.13K/2021 të datës 03.08.2021 të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti për

Krime të Rënda. Ndërlidhur me këtë e në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 63 paragrafi 3 ku përcaktohet se : 3. *Në rast të inicimit të procedurës penale kundër nëpunësit civil për kryerjen e veprës penale gjatë ushtrimit të mandatit të tij/saj administrativ, që mund të rezultojë në krijimin e kushteve për ngritjen e padisë kundër nëpunësit civil, të gjitha procedurat disiplinore lidhur me rastin nuk mund të iniciohen deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata kompetente”, Kolegji vlerëson se shkelja disiplinore si me lartë nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit në procedurë disiplinore deri në një vendim përfundimtar të gjykatës.*

Andaj, bazuar në të gjeturat dhe konstatimet si me lartë, Kolegji vlerëson se Vendimi KPK/Nr.661/2021 i datës 24.08.2021 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankuesit është i përfshirë me shkelje materiale të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil të Kosovës dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që mbi këtë bazë e në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, një vendim i nxjerrë me shkelje material dhe në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ konsiderohet akt administrativ i paligjshëm, rrjedhimisht mbi këto arsye rezulton se pretendimi ankimor për anulimin e Vendimit KPK/Nr.661/2021 të datës 24.08.2021 është i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për kthimin e tij në vendin e punës Drejtor i Përgjithshëm i SKPK-së, Kolegji duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 15 paragrafi 3 dhe nenit 90 paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/149 për Shërbimin Civil sipas të cilave normave është përcaktuar së mandati për pozitën e nivelit të lartë drejtues janë me afat të caktuar tre vjeçar dhe që marrëdhënia e punës përfundon me skadimin e kontratës së punës, si dhe duke marrë parasysh praktiken gjyqësorë sipas Aktgjykimit AA.nr.420/201 të datës 05.11.2019 dhe Aktgjykimit AA.nr.403/2016 të datës 05.11.2019 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Aktgjykimit A.nr.1/2018 të datës 24.05.2018 dhe Aktgjykimit A.449/2016 të datës 25.10.2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Kolegji konstaton së kthimi i ankuesit në pozitën e Drejtorit të përgjithshëm është ligjërish i pamundur sepse referuar Vendimit KPK/Nr.20/2019 të datës 14.01.2019 mandati i ankuesit në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës ka përfunduar me datë 12.02.2022, kështu që në këtë kuptim është i pabazuar pretendimi ankimor.

Përkitazi me pretendimin ankimor të ankuesit për kthimin e tij në listë të pagave dhe kompensimin e pagave nga data e largimit nga lista e pagave, Kolegji nga vlerësimi i provave materiale ka vërtetuar se ankuesi me Vendimin KPK/Nr.57/2021 të datës 02.03.2021 ishte pezulluar nga ushtrimi i detyrave zyrtare me pagesë 50% të pagës, ndërsa me datë 24.08.2021 është larguar tërësisht nga lista e pagave, mirëpo në ripoçedurë gjegjësisht me datë 03.06.2022 Këshilli është informuar se organi i punësimit ka bërë kompensimi e 50% të pagës së ndalur për ankuesin për periudhën nga 24.08.2021 deri në përfundimin e mandatit, kështu që nisur nga ky fakt rrjedh se qëllimi i pretendimit ankimor për kompensimin e pagave dhe përfitimeve tjera është bërë i pamundur respektivisht i kotë.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.854/2021

Rushit KAJTAZI


Procesmbajtës

Ardita HAXHNIKAJ DEMI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Këshillin Prokurorial të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

